



unicef 
for every child

STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR



2018

**STANDARDET PROFESIONALE TË
FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË
MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR**

Publikimi “**Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor**” u realizua në kuadrin e bashkëpunimit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit me UNICEF-in. Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF. Manuali u hartua nën kujdesin e znj. Mirlinda Bushati, drejtuese e programit të Edukimit dhe Fëmijërisë së herhme në UNICEF Shqipëri.

Grupi i punës u udhëhoq nga:

- | | |
|----------------------|--|
| Z. Gerti Janaqi | Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit |
| Znj. Aurela Zisi | Specialiste e arsimit fillor dhe parashkollor, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit |
| Znj. Shqiponja Lamçe | Specialiste e arsimit parashkollor, në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë |

Në hartimin e standardeve kanë kontribuar pedagogë të Fakultetit të Shkencave sociale dhe të Fakulteve të mësuesisë, specialistë të arsimit parashkollor pranë drejtorive arsimore rajonale, mësues dhe drejtues të arsimit parashkollor, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile etj.

© Copyright 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për IZHA dhe UNICEF, Tiranë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME.....	4	
1.1	HYRJE	4
1.2	PËRSE VLEJNË KËTO STANDARDE?	6
1.3	STRUKTURA E STANDARDIT	9
PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR.....	10	
2.1	PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS.....	10
2.2	ORGANIZIMI I STANDARDEVE	11
2.3	STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR	12
2.3.1	Standardi 1. Zbatimi i kodit të etikës.....	12
2.3.2	Standardi 2. Bashkëpunimi me kolegët, familjarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit.....	14
2.3.3	Standardi 3. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e vet profesional.....	17
2.3.4	Standardi 4. Zbatimi i dokumentacionit të ri kurrikular të arsimit parashkollor.....	19
2.3.5	Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies dhe zbatimi i teknologjisë.....	23
2.3.6	Standardi 6. Rritja, zhvillimi dhe mënyrat si nxënë fëmijët parashkollorë.....	26
2.3.7	Standardi 7. Pranimi dhe respektimi i diversitetit.....	28
2.3.8	Standardi 8. Mbrojtja fizike, shëndeti fizik dhe emocional.....	30
2.3.9	Standardi 9. Mjedësi fizik.....	33
2.3.10	Standardi 10. Vlerësimi në arsimin parashkollor.....	36
2.3.11	Standardi 11. Vlerat dhe kompetencat e mësuesit në arsimin gjithëpërfshirës.....	39

1.1 HYRJE

Zbatimi i reformës kurrikulare bazuar në kompetenca kërkon ndryshimin e rolit dhe të përgjegjësive të mësuesit, të institucionit arsimor parashkollor, si dhe pritshmërinë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca kërkon mësues cilësisht të aftë *për të përmbushur* zhvillimin e përgjithshëm dhe të nxënit e fëmijëve, *të përkushtuar* ndaj interesave e nevojave të tyre, *për të përzgjedhur* lojëra, veprimtari, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë procesin e të nxënit sa më efektiv.


Paketa e zhvillimit profesional të mësuesve, pjesë e së cilës është dhe dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit të arsimit parashkollor, kërkon që mësuesi të ketë në vëmendje arritjet e fëmijëve sipas fushave të zhvillimit dhe të të nxënit, të përcaktuara në Standardet e parashkollorit.

Të gjithë mësuesve që janë në shërbim u është krijuar mundësia e zhvillimit profesional, nëpërmjet të cilit përditësojnë informacionin, të jenë në kontakt me zhvillimet e fundit dhe prioritetet në edukim. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm, ndihmon çdo mësues të *“rritet”* dhe të vlerësojë performancën e vet.

“Mësuesia” është profesioni më i rëndësishëm që ndikon në formimin e brezit të ardhshëm prandaj

synohet të formohet dhe të zhvillohet bazuar në standarde, të cilat përcaktojnë *çfarë* duhet të dijë çdo mësues, *çfarë* aftësish duhet të tregojë dhe nga *ç'vlera* dhe cilësi duhet të karakterizohet.

Procesi nëpër të cilin kalon çdo fazë në zhvillimin dhe rritjen profesionale të mësuesit paraqitet në diagramin e mëposhtëm.



Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit, i hartuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, në bashkëpunim me specialistët më të mirë të fushës, ka për qëllim kryesor të japë një vizion të ri për mësimdhënien, me fokus plotësimin e nevojave dhe të interesave individuale të çdo fëmije parashkollor. Mësuesi që shfaq interes të vazhdueshëm për zhvillim profesional, që merr rezultate të larta në kualifikime, që vlerësohet për përkushtimin dhe përfshirjen në trajnimet ku merr pjesë arrin rezultate shumë të mira në punën e përditshme me fëmijët.

Standardet nuk duhet të ngatërrohen dhe as të zëvendësojnë detyrimet profesionale që parashikohen në dokumentet e ndryshme ligjore apo nënligjore që përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e mësuesit.

1.2 PËRSE VLEJNË KËTO STANDARDE?

Standardet profesionale të mësuesit përshkruajnë atë që pritet të njohë, të përmbushë dhe të demonstrojë mësuesi i arsimit parashkollor.

a) Këto standarde i vlejné së pari **vetë mësuesit**. Mësuesi mbështetet në to për të vlerësuar performancën, për të evidentuar anët e forta dhe nevojat për zhvillim profesional. Nëpërmjet këtyre standardeve mësuesi njihet me *vizionin dhe konceptin e ri për mësimdhënien dhe të nxënit*. Për të përmirësuar cilësinë e veprimtarisë mësimore-educative, mësuesi analizon gjendjen në të cilën ndodhet përgatitja e tij profesionale dhe vendos prioritetet për zhvillimin e mëtejshëm.

Standardet përfshijnë një sërë *treguesish* të njohurive, aftësive dhe vlerave, për të cilat mësuesi angazhohet për t'i përmbushur me sukses dhe për të treguar sa kompetent është në profesionin që ushtron.

Nivelet e performancës tregojnë sa një mësuesi i përmbush këto standarde. Në momentin që mësuesi është i qartë se çfarë duhet të arrijë, ai punon për

rritjen dhe *zhvillimin e vet profesional* duke marrë pjesë në trajnime dhe kualifikime.

- b) Standardet profesionale të mësuesit i lehtësojnë punën **drejtuesit** të institucionit parashkollor (ose të drejtuesit të shkollës, nëse brenda institucionit ka grupe parashkollori të moshës 3-6 vjeç). Nëpërmjet treguesve të përmbushur të standardeve, drejtuesi i institucionit vlerëson periodikisht performancën e mësuesit, ngritjen profesionale dhe jep sugjerime për trajnime e kualifikime. Vendimi për përzgjedhjen e një mësuesi në një institucion arsimor duhet të merret pas përgjigjes së pyetjes: *“Sa i përmbush kandidati-mësues treguesit e standardeve të mësuesit?”*.
- c) Përfaqësuesve të **komunitetit në** Bordin e kopshtit dhe në Këshillit e prindërve u shërben shqyrtimi i standardeve për të kuptuar cilësinë e shërbimit arsimor që ofron institucioni parashkollor.
- d) **Ministria e Arsimit, e Sportit dhe e Rinisë** niset nga këto standarde për të formuluar politikat mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit. Mbi këto standarde bazohet kualifikimi dhe trajnimi i mësuesve.
- e) **Instituti i Zhvillimit të Arsimit** identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar.

- f) **Inspektorati Shtetëror i Arsimit** ndihmon mësuesit në përmbushjen e këtyre standardeve duke kryer vlerësimin e jashtëm të performancës së tyre.
- g) **Njësitë arsimore vendore** (DAR/ZA-të) mbështetur në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe sipas profileve hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.
- h) **Fakultetet e edukimit** mbështeten në këto standarde për të hartuar me koherencë standardet e formimit fillestar të mësuesve, si dhe kurrikulën përkatëse, referuar formimit shkencor sipas profilit dhe formimit të përgjithshëm, duke i përgatitur studentët për licencim.
- i) **Këshillat dhe shoqatat e mësuesve** kanë parasysh të dy llojet e standardeve për të veçuar ato nevoja profesionale, të cilat janë më të domosdoshme për t'u plotësuar në nivel institucioni arsimor, si dhe për të planifikuar veprimtarinë e zhvillimit profesional të mësuesve dhe këshillimin të tyre profesional.
- j) Po kështu, **OJF-të, donatorët** dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve kanë nevojë për një dokument të plotë të standardeve profesionale të mësuesit, në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të përzgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

1.3 STRUKTURA E STANDARDIT

Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.

Struktura e standardit përmban titullin e tij dhe përshkrimin e përmbledhur të standardit. Ky standard zërthehet në *disa tregues të detajuar dhe të matshëm*, të cilët i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi.

PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

2.1 PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS

Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit janë hartuar duke u bazuar në dokumente rekomanduese¹ hartuar nga Komisioni Evropian. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç'shikallë është përmbushur një standard i caktuar.

Standardet nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si një e tërë, ku secili standard, bashkë me treguesit e tij, vështron një aspekt të rëndësishëm të mësuesit cilësor.

Standardet e mësuesit të arsimit parashkollor përshkruajnë karakteristikat themelore të një mësuesi cilësor në mënyrë të përmbledhur, të qartë dhe e bëjnë dokumentin lehtësisht të përdorshëm. Ato vijnë si rezultat i kërkimeve dhe i përvojave më të fundit në fushën e zhvillimit profesional që kanë ndodhur në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare.

¹“Supporting teacher competence development, for beter learning”

Standardet mbrojnë personalitetin e mësuesit cilësor dhe ndikojnë ndjeshëm në rritjen e përkushtimit të tij për profesionin që ushtron. Mësuesi, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të profesionalizmit të tij për të konfirmuar nivelin ku ndodhet, përmirësimet që duhet të bëjë dhe të hartojë planin e zhvillimit profesional.

2.2 ORGANIZIMI I STANDARDEVE

Dokumenti përmban 11 standarde të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e mësuesit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me zotërimin e përmbajtjes shkencore të dokumentacionit kurrikular të arsimit parashkollor; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili fëmijë dhe i rritur ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e mësuesit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të kurrikulës së re; me përdorimin e metodave të larmishme të vlerësimit të arritjeve të fëmijëve, si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive ndërmjet kopshtit, familjes dhe komunitetit.

Për secilën standard është bërë një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes dhe më tej janë dhënë treguesit specifikë të përmbushjes së tij.

2.3 STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

2.3.1 Standardi 1. Zbatimi i kodit të etikës

2.3.1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor vepron me respekt, integritet dhe në mënyrë etike kudo që ndodhet, brenda dhe jashtë mjediseve të institucionit. Vlerat dhe parimet e dhëna në Kodin e etikës qëndrojnë në themel të funksionimit të procesit mësimor, në të gjitha mjedisit shkollore e komunitare.

Mësuesi njeh parimet e kodit të etikës që bazohen në vlera universale, të tilla si: drejtësia, paanësia, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, dinjiteti etj. Mësuesi tregon përkushtim ndaj fëmijës dhe procesit të zhvillimit dhe të të nxënit, tregon përkushtim ndaj profesionit, mjedisit mbështetës dhe komunitetit.

2.3.1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. është njohës i mirë i kodit të etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat;
2. zbaton parimet e etikës, rregullat e sjelljes dhe të komunikimit që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, fëmijët, prindërit dhe komunitetin;
3. kryen me ndershmëri punën e tij si edukator i brezit të ri;

4. *krijon* besueshmëri dhe respekt nëpërmjet sjelljeve dhe vlerave të tij;
5. *përmbush* detyrimet ligjore dhe kontraktuale;
6. *i trajton* fëmijët, prindërit, kolegët dhe drejtuesit me respekt, drejtësi dhe me dinjitet;
7. *mbron* të drejtat dhe raportet konfidenciale të fëmijëve, kolegëve, prindërve të grupit etj.;
8. *vishet* me veshjen e duhur si në kopsht edhe jashtë tij;
9. *krijon* një mjedis pozitiv që përcjell vlerat themelore të demokracisë;
10. *merr* vendimet e duhura në rastet e dilemave etike.

2.3.2 Standardi 2. Bashkëpunimi me kolegët, familjarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit

2.3.2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor bashkëpunon së bashku me stafin pedagogjik të kopshtit, me familjet dhe komunitetin për të mbështetur zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve.

Prindërit janë personat më të rëndësishëm në jetën e një fëmije prandaj dhe pjesëmarrja e tyre në veprimtaritë e kopshtit, është e domosdoshme. Mësuesi nxit partneritetin me familjet dhe u ofron mundësi të shumta prindërve dhe anëtarëve të komunitetit që të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve. Mësuesi vlerëson ndikimin që ka komuniteti në zhvillimin e fëmijës dhe në plotësimin e nevojave të tij.

2.3.2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. *shfaq* gatishmëri dhe përfshihet në bashkëpunimet dhe bashkëveprimet kudo që ia kërkon puna;
2. *mirëpret* prindërit në kopsht në çdo kohë;
3. *bën* takime rutinë, në mënyrë të vazhdueshme me prindërit, për ecurinë dhe shëndetin e fëmijëve;
4. *i dëgjon* me vëmendje dhe zhvillon komunikim efektiv me prindërit dhe familjarët e fëmijëve;
5. *mbështet* dhe *kontribuon* për kulturën e komunitetit, vlerat dhe traditat e tij;
6. *ofron* mundësi të barabarta për çdo fëmijë dhe familje që të mësojnë dhe marrin pjesë

- pavarësisht nga gjinia, raca, origjina etnike, kultura, gjuha, feja, struktura familjare, statusi social, statusi ekonomik etj.;
7. *vlerëson* mendimet, idetë dhe sugjerimet që japin prindërit dhe të afërmit e fëmijëve të grupit;
 8. *përcjell* në kohën e duhur te prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve informacionet që lidhen me arritjet, veprimtaritë, progresin dhe mbarëvajtjen e tyre;
 9. e *zhvillon* komunikimin si një proces të dyanshëm dhe i nxit prindërit dhe kujdestarët që të marrin pjesë në diskutime rreth ecurisë dhe mbarëvajtjes së fëmijëve;
 10. *vendos* qëllime të përbashkëta për bashkëpunime të frytshme me prindërit;
 11. *komunikon* në mënyrë efektive me familjarët dhe u kërkon mbështetje për punën me fëmijët;
 12. *nxit* pjesëmarrjen e familjarëve dhe të anëtarëve të komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarisë mësimore-edukative;
 13. *krijon* linja të hapura dhe aktive të komunikimit me fëmijët, prindërit dhe të tjerët;
 14. *gjen* mundësi të vazhdueshme për të ndërtuar një partnership të fortë me prindërit dhe anëtarët e komunitetit;
 15. *fton* prindërit të marrin pjesë aktive në veprimtaritë e organizuara në kopsht;
 16. *përdor* mënyra të larmishme për të shkëmbyer përvoja, materiale dhe tema që kanë lidhje me profesionin;
 17. *harton* plane edukative individuale në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve dhe

- specialistët e fushës në të cilën fëmija paraqet aftësinë e kufizuar;
18. *analizon* me fëmijët raste kur ndikimi i komunitetit mund të jetë pozitiv apo negativ (mund të ndodhë që fëmija në komunitet të mësojë diskriminimin, paragjykimin, racizmin etj., por mund të ndodhë edhe e kundërta, që fëmija të gjejë aty mundësitë, lojërat, respektin dhe dashurinë e të tjerëve, duke bërë që ai të zhvillohet si qytetar i denjë i shoqërisë demokratike);
19. *bashkëpunon* me kolegët, familjarët dhe anëtarët e komunitetit për marrjen e vendimeve të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e kopshtit.

2.3.3 Standardi 3. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e vet profesional

2.3.3.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor interesohet dhe merr pjesë në veprimtari që janë të lidhura me aspekte të ndryshme të zhvillimit profesional. Këto veprimtari mund të jenë të iniciuara prej tij, të kërkuara nga institucioni shkollor ose të diktuar nga nevoja për trajnim dhe kualifikim të vazhdueshëm. Ato ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e praktikës së përditshme të punës me fëmijët. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional ka lidhje me njohjen dhe respektimin me përgjegjshmëri të kërkesave të Legjislacionit arsimor dhe të dokumentacionit shkollor.

2.3.3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. zotëron ligjin “ Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe Dispozitat normative të këtij sistemi;
2. zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit;
3. zbaton legjislacionin, standardet dhe udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e dokumentacionit kurrikular;
4. respekton të drejtat dhe liritë e fëmijës;
5. respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;
6. demonstroi përkushtim dhe dëshirë për të nxënë gjatë gjithë jetës;
7. hartoi një plan të qartë afatgjatë për zhvillimin e vet profesional;

8. *merr pjesë në seminare dhe trajnime sistematike të lidhura me edukimin dhe kujdesin ndaj fëmijës;*
9. *diskuton me të tjerët dhe ndan mendime për çështje të ndryshme profesionale;*
10. *kërkon e shfrytëzon literaturë profesionale, si dhe burime të shumta informacioni, duke siguruar një plan zhvillimi profesional për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit;*
11. *shkëmben dhe ndan përvoja me kolegë dhe reflekton ndaj ideve të reja;*
12. *respekton konfidencialitetin dhe zbaton standarde të larta etike, ligjore që kanë në qendër fëmijën dhe familjen e tij, duke siguruar një kulturë bashkëpunuese dhe klimë pozitive brenda dhe jashtë mjedisit fizik të shkollës;*
13. *ndihmon një mësues të ri për zgjidhjen dhe kapërcimin e vështirësive të ndryshme profesionale;*
14. *zgjedh dhe merr pjesë në atë veprimtari profesionale që lidhet me profesionin e mësuesisë;*
15. *dëshmon përmirësim në arritjet profesionale;*
16. *merr pjesë dhe jep kontributin e vet në rrjetin profesional ku bën pjesë.*

2.3.4 Standardi 4. Zbatimi i dokumentacionit të ri kurrikular të arsimit parashkollor

2.3.4.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor zotëron përmbajtjen e paketës kurrikulare në të cilën përfshihen: Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor, Kurrikula bërthamë nga klasa përgatitore deri në klasën e pestë, Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç dhe Programet e parashkollorit.

Në përputhje me nevojat, interesat dhe mundësitë e fëmijëve, mësuesi vë në zbatim kurrikulën gjithëpërfshirëse e të integruar, të mbështetur në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

2.3.4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. *qëndron* i mirinformuar për zhvillimet dhe risitë e reformës kurrikulare në arsimin parashkollor;
2. *studion* dhe *diskuton* rreth dokumentacionit të ri kurrikular të arsimit parashkollor;
3. *analizon* si përshkallëzohen njohuritë dhe shkathtësitë e programeve dhe treguesit e Standardeve të zhvillimit dhe të të nxënit nga njëra grupmoshë në tjetrën;
4. *përdor* materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive nga ana e fëmijëve;
5. *shpjegon* lidhjen Standard - Program - Plan mësimor vjetor, 3 mujor dhe mujor;
6. *planifikon* kurrikulën në përputhje me zhvillimin

- moshor, psikologjik, interesat dhe nevojat e fëmijëve;
7. *planifikon* kurrikulën në mënyrë të tillë që çdo fëmijë të ketë sukses;
 8. *është* i qartë për kërkesat e diferencuara të programeve për secilën grupmoshë;
 9. *zhvillon* projekte dhe mësimë tematike brenda të cilave integrohen njohuritë nga fushat e programeve;
 10. *mbështet* entuziazmin e fëmijëve, habinë dhe kuriozitetin e tyre dhe i ndihmon t'i kuptojnë gjërat më mirë;
 11. *nxit* fëmijët të jenë aktivë dhe të përfshihen në veprimtari të ndryshme;
 12. *përdor* gjuhë të kuptueshme për t'u mësuar fëmijëve konceptet kryesore;
 13. në hartimin e kurrikulës, *mban* parasysh nevojat e veçanta të fëmijëve, aftësitë, sjelljet dhe karakteristikat e zhvillimit të tyre;
 14. *shpjegon* duke u mbështetur në situata dhe raste konkrete;
 15. *përcakton* rezultatet e duhura të të nxëniet për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat (shkathtësitë) e programit;
 16. *planifikon* projekte kurrikulare dhe module mësimore;
 17. *përzgjedh* mjetet e nevojshme mësimore për të realizuar përmbushjen e kërkesave të programeve lëndore;
 18. *diskuton* me kolegët dhe specialistë lëndorë për çështje të ndryshme kurrikulare;

19. *përdor* larmi metodash, lojërash dhe veprimtarish duke ia përshtatur natyrës dhe specifike të çdo programi lëndor;
20. *përdor* mjete teknologjike për zhvillimin e rrugëve të përshtatshme që lehtësojnë zotërimin e koncepteve lëndore.

Gjuha shqipe

Gjuha shqipe bën pjesë në fushën e të nxënësve “Gjuha dhe komunikimi”. Kjo lëndë është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi gjuhësor”, u mundëson fëmijëve të zhvillojnë dhe ta përdorin gjuhën si mjet komunikimi në jetën e përditshme, në veprimtaritë e tyre mësimore e shoqërore, duke përmbushur kompetencat gjuhësore: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*.

Matematika

Fusha e matematikës është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme” me nënfushën “Zhvillimi matematik”. Nëpërmjet veprimtarive praktike fëmijët fitojnë kompetenca matematike, të tilla si: *zgjdhja e situatës problemore; arsyetimi dhe vërtetimi matematik; të menduarit dhe komunikimi matematik; lidhja konceptuale dhe modelimi matematik*.

Shkencat e natyrës

Fusha “Shkencat e natyrës” është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme”, nënfusha “Zhvillimi shkencor”. Nëpërmjet veprimtarive shkencore fëmijët mësojnë *të identifikojnë probleme dhe të gjejnë zgjidhjen e tyre, të përdorin mjete, objekte dhe procedura shkencore, të komunikojnë në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës*.

Shoqëria dhe mjedisi

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” është e lidhur me

standardet e fushës “Zhvillimi social dhe vetjak”. Nëpërmjet situatave konkreteve dhe rasteve nga jeta e përditshme fëmijët zhvillojnë kompetencat *sociale, ndërpersonale dhe qytetare*.

Artet

Fusha “Artet” është e lidhur me standardet e fushës “Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme”, nënfusha “Zhvillimi artistik”. Nëpërmjet veprimtarive dhe punimeve artistike fëmijët fitojnë kompetencat *e krijimit, të performimit dhe të vlerësimit artistik*.

Edukimit fizik, sporte dhe shëndeti

Fusha “Edukimi fizik, sporte dhe shëndet” është e lidhur me standardet e fushës “Shëndeti, mirëqenia fizike dhe zhvillimi motorik”. Nëpërmjet veprimtarive dhe lojërave të ndryshme fëmijët zhvillojnë *aftësi lëvizore, ndërveprojnë me të tjerët në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive, dhe përgatiten të bëjnë stil jete aktiv e të shëndetshëm*.

2.3.5 Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies dhe zbatimi i teknologjisë

2.3.5.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor e planifikon dhe e zhvillon mësimdhënien bazuar në zhvillimin moshor të fëmijëve, në teoritë e zhvillimit dhe të të nxënit dhe sipas kërkesave të kurrikulës zyrtare.

Mësuesi përdor metoda, praktika dhe burime të larmishme për të nxitur zhvillimin individual, të nxënët dhe bashkëpunimin reciprok. Ai është njohës dhe përdorues i mirë i programeve të kompjuterit, i siteve të internetit dhe i përdor kur është e nevojshme në procesin e të nxënit. Zhvillon mësimdhënie multimediale, duke përdorur teknologji të reja që nxitin efektivitetin e të nxënit tek fëmijët.

2.3.5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. është njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënit dhe i psikologjisë moshore të fëmijëve me të cilët punon;
2. njeh teoritë kryesore të zhvillimit dhe të të nxënit;
3. shfrytëzon literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit;
4. zotëron njohuri për arsimin gjithëpërfshirës;
5. planifikon veprimtari ditore duke u bazuar në mësimdhënien me fëmijën në qendër;
6. analizon programet e edukimit Hap pas hapi,

- Rexhio Emilja dhe përdor elemente të tyre në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës;
7. *përdor* metoda të larmishme mësimdhënieje, lojëra dhe veprimtari praktike që japin rezultate pozitive të fëmijët;
 8. *përdor* metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;
 9. *krijon* balanca ndërmjet punës individuale, punës në grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën.
 10. *përdor* metoda dhe forma pune që i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe shprehje për jetën;
 11. *njeh* programe kompjuteri ëord, poëer point etj., të cilat i përdor në veprimtari të ndryshme mësimore-edukative;
 12. *prezanton* materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike;
 13. *pranon* faktin që fëmijët parashkollorë mund të nisnin të mësojnë burimet bazë të teknologjisë, si kompjuterin, programe didaktike, internetin etj.;
 14. *drejton* dhe *mbikëqyr* fëmijët në përdorimin e teknologjisë, për t'i mbështetur në të mësuarit e tyre;
 15. *kërkon* dhe *përdor* aparatura të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta, i motivon ata për të rritur nivelin e përfshirjen gjatë veprimtarisë mësimore-edukative;
 16. *krijon* situata që nxisin të menduarit dhe të arsyetuarit e fëmijëve;
 17. *planifikon* dhe *ruan* raportet ndërmjet veprimtarive brenda e jashtë kopshtit, ndërmjet veprimtarive të qeta dhe aktive, ndërmjet

- veprimtarive individuale, në grup të vogël dhe në grup të madh;
18. *përfshihet* në vetëreflektim të vazhdueshëm, për të përmirësuar praktikën profesionale, duke treguar prova të përmirësimit të tij në mësimdhënie;
 19. *vlerëson* çdo informacion në mënyrë kritike, duke krijuar personalitetin e vet në përputhje me zhvillimet e kohës si dhe përmbush nevojat e fëmijëve, duke siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie dhe nxënie për të gjithë;
 20. *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: në grup të madh; në grup të vogël dhe individuale;
 21. *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të lira; të sugjeruara dhe të drejtuara;
 22. *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, në ato që kërkojnë përqendrim e vëmendje apo çlodhëse;
 23. *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, që zhvillohen në mjedis të ndryshme (ulur, në këmbë, në pozicion çlodhës, në të njëjtin vend apo në vende të ndryshme), në një mjedis tjetër të kopshtit, brenda apo jashtë kopshtit;
 24. *zhvillon* forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të udhëhequra nga mësuesja e grupit apo të udhëhequra nga një person tjetër (prindi) apo nga vetë fëmijët;
 25. *zbaton* kohëzgjatjen e veprimtarive duke sugjeruar përdorimin e këndeve dhe lodrave, në funksion të moshës së fëmijëve.

2.3.6 Standardi 6. Rritja, zhvillimi dhe mënyrat si nxënë fëmijët parashkollorë

2.3.6.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor njih natyrën e rritjes, të zhvillimit dhe të afësive për të nxënë të fëmijëve 3-6 vjeç. Proceset e zhvillimit dhe të të nxënimit ndjekin njëra-tjetrën dhe ndikohen nga faktorë të ndryshëm ekonomikë, socialë e kulturorë. Fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme, por loja dhe eksplorimi mbeten veprimtaritë kryesore prej të cilave ata mësojnë. Në këtë proces të gjatë mësuesi krijon bashkëpunim me prindërit për t'iu përgjigjur më mirë nevojave dhe interesave individuale të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç.

2.3.6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. qëndron koherent ndaj zhvillimeve që ndodhin në fushën e fëmijërisë së hershme;
2. pranon faktin se fëmijët janë të ndryshëm, kanë stile të ndryshme të nxënimit dhe ia përshtat mësimdhënien interesit të tyre më të lartë;
3. përdor shumëllojshmëri praktikash dhe burimesh për të nxitur zhvillimin individual të çdo fëmije;
4. krijon mjedis pozitiv, mbështetës dhe të sigurt për fëmijët ku respektohet diversitetet e fëmijëve;
5. zhvillon veprimtari të përshtatshme që nxisin përparimin e çdo fëmije;
6. harton plane në përputhje me interesat dhe aftësitë e fëmijëve të cilat stimulojnë zhvillimin

- fizik, social, emocional dhe intelektual;
7. *monitoron* dhe dokumenton sjelljen dhe veprimtarinë e çdo fëmije;
 8. *nxit* imagjinatën dhe fantazinë e çdo fëmije;
 9. *ndihmon* fëmijët të bëjnë zgjedhje dhe të punojnë të pavarur sipas interesave dhe nevojave që kanë;
 10. *bisedon* me fëmijët për të mësuar më shumë rreth ideve, vlerave, shqetësimeve dhe dëshirave që kanë;
 11. *pranon* rolin e familjes si një partner i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës duke ndarë informacione dhe duke marrë vendime së bashku;
 12. *promovon* fëmijët me prirje të veçanta në veprimtari të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.3.7 Standardi 7. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

2.3.7.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor ndikon në zhvillimin cilësor të të gjitha marrëdhënieve brenda klasës. Ai pranon dhe merr në konsideratë interesat individuale të fëmijëve, aftësitë dhe stilet e ndryshme të të nxënësve që paraqesin. Mësuesi respekton ndryshimet ndërmjet individëve dhe nevojave të tyre të veçanta; i trajton të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe dinjitoze.

2.3.7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. është vëzhgues i mirë i fëmijëve;
2. mban parasysh faktin se çdo fëmijë është sa unik aq sa është dhe pjesë e bashkësisë së fëmijëve të klasës;
3. i thërret të gjithë fëmijët me emër;
4. identifikon fëmijët që kanë një vlerësim të ulët për veten;
5. përballon nevojat e çdo fëmije në grup. Ia përshtat mjedisin e të nxënësve nevojave të çdo fëmije;
6. krijon një mjedis të nxënësve të tillë ku secili e ndjen veten të respektuar, të nderuar e të vlerësuar për potencialin e tyre;
7. tregon respekt për çdo fëmijë dhe familjen e tij, pavarësisht prejardhjes dhe kulturës së saj;
8. merr parasysh se procesi i të nxënësve ndikohet nga përvojat vetjake, talenti, gjuha, kultura, familja

- dhe komuniteti;
9. *është* i ndjeshëm ndaj komuniteteve, kulturave të ndryshme si dhe normave të tyre;
 10. *krijon* situata të qëllimshme ku fëmijët arrijnë suksese, duke ndihmuar çdo fëmijë të përmbushë potencialin e tij;
 11. *nxit* interesat e fëmijëve dhe përgëzon përpjekjet e tyre, duke shfaqur besimin që ka në aftësitë e tyre;
 12. *shfaq* respekt për të gjithë fëmijët, pa përjashtim, pa diskriminime negative ose pozitive;
 13. *organizon* aktivitete të veçanta ku fëmijë shfaqin anët e forta apo kuptojnë nevojat e tyre për përmirësim;
 14. *mundëson* rrugë të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve ose të situatave të vështira brenda klasës;
 15. *përcakton* mbi bazën e njohurive që zotëron nëse një fëmijë është me aftësi të kufizuar apo paraqet vështirësi në të nxënë;
 16. *harton* plane edukative individuale për fëmijët që kanë nevojë për program të veçantë pune;
 17. *bashkëpunon* me kolegë dhe me specialistë për zhvillimin e talenteve të fëmijëve.

2.3.8 Standardi 8. Mbrojtja fizike, shëndeti fizik dhe emocional

2.3.8.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron konceptet kryesore rreth aftësive dhe mjeteve të kontrollit për mbrojtjen e shëndetit dhe të edukimit fizik të fëmijëve; siguron hapësira të kënaqshme që përmbushin kriteret për shëndetin dhe edukimin fizik të fëmijëve; merr masa dhe ndjek procedurat e sigurisë së jetës së fëmijëve, përfshirë dhe fëmijët e abuzuar dhe të braktisur.

2.3.8.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. *organizon* një mjedis të përshtatshëm emocional dhe afektiv, duke i ofruar fëmijëve rehati, çlodhje, mjedis pa zhurmë, temperaturë të përshtatshme të mjedisit, zgjedhje personale e vendit nga vet fëmija apo praninë e një sendi apo lodre familjare për fëmijën;
2. *përgatit* dhe shpërndan materiale që lidhen me mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të fëmijëve;
3. *informon* familjarët që zhvillimi i aftësive motorike, zakonet jetësore të shëndetshme dhe të qenit i informuar është pjesë e rëndësishme e procesit të rritjes së fëmijëve, mirëqenies së shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve;
4. *informon* familjarët për ndikimin e faktorëve fizikë, emocionalë dhe socialë mbi shëndetin personal të fëmijëve;
5. *përcakton* rreziqet kryesore të shëndetit të fëmijëve, siguron dhe parandalon situatat që

- çojnë fëmijët drejt këtyre rreziqeve;
6. *dallon* rastet e dëgjimit të pakët, të humbjes së shikimit, të sëmundjeve infektive, të abuzimit, të mungesës së ushqimit, të problemeve me dhëmbët, të mungesës së gjumit dhe gjithë ndikimet negative ndaj shëndetit të tyre;
 7. *punon* efektivisht me anëtarët e stafit, përfshirë mjekun, punonjësin social, psikologun dhe prindërit me qëllim që të zhvillojnë strategji të përshtatshme ndërhyrjeje për fëmijët me prirje, mundësi dhe nevoja të veçanta;
 8. *merr* masa për të siguruar mirëqenien fizike të fëmijëve, duke krijuar kushte të përshtatshme të fjetjes dhe higjienës personale;
 9. *përcakton* aftësitë e veçanta, përpjekjet individuale, arritjet, talentin dhe prirjet e fëmijëve;
 10. *organizon* veprimtari të larmishme, të tilla si ecje, kërcime, lojëra të ndryshme, veprimtari çlodhëse që e zhvillojnë fëmijën në drejtimin fizik;
 11. *zhvillon* tema mësimore që kanë lidhje me mbrojtjen dhe kujdesjen ndaj fëmijëve në situata të vështira, dëmtime apo tragjedi të mundshme;
 12. *trajton* çështje që lidhen me shëndetin, të ushqyerit, të sigurisë, të veshurit, të higjienës personale dhe funksionimit të tualetit nisur nga përvojave jetësore dhe situata konkrete;
 13. *u jep* shanse fëmijëve të realizojnë lëvizje, të njohin trupin e tyre dhe të kuptojnë se çfarë mund të bëjnë me të;
 14. *zhvillon* veprimtari dhe lojëra që i zhvillojnë aftësitë mendore të fëmijëve;

15. *bashkëpunon* me fëmijët për përdorimin e pajisjeve të kopshtit gjatë lojës apo veprimtarive fizike;
16. *është* i trajnuar për radhën e veprimeve në rast të ndonjë emergjence (zjarr, tërmet etj.).

2.3.9 Standardi 9. Mjedisi fizik

2.3.9.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor krijon në klasë një mjedis pozitiv, paqësor, mikpritës dhe gjithëpërfshirës, të sistemuar nga ana fizike dhe me lehtësi për t'u shfrytëzuar nga fëmijët në çdo veprimtari ditore.

Mjedisi përshatet në mënyrë të tillë që të lehtësojë zhvillimin dhe të nxënët e fëmijëve. Ai pasurohet dhe ndryshon vazhdimisht falë bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve të grupit.

2.3.9.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. *krijon* një mjedis emocional pozitiv, të përshatshëm për shëndetin dhe sigurinë e çdo fëmije;
2. *ndërton* një mjedis në mënyrë të tillë që të gjithë fëmijët nxiten të marrin pjesë, të ndërveprojnë, të luajnë dhe të mësojnë;
3. *ndërton* një mjedis fizik të brendshëm në mënyrë të tillë që fëmijët të kenë mundësi të punojnë individualisht, në grup të vogël ose në grup të madh;
4. në mjedisin e jashtëm fizik u *krijon* mundësi fëmijëve që të qëndrojnë dhe të luajnë në ajër të pastër;
5. *krijon* hapësirat e nevojshme për të zhvilluar eksperimente, për të vendosur aparatura dhe pajisje audiovizuale, me qëllim futjen e njohurive

- bashkëkohore dhe përmirësimin e të nxënit të fëmijëve;
6. *përpiqet* për t'ua përshtatur mjedisin fëmijëve me aftësi të kufizuar;
 7. *pasuron* klasën me mjete mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore - edukative dhe klimë pozitive bashkëpunimi;
 8. *punon* brenda parimeve etike, profesionale dhe ligjore, në përputhje me Dispozitat Normative.
 9. *Përdor* teknika udhëzuese pozitive për të nxitur vetërregullin, detyrimet dhe të drejtat e fëmijëve në mënyrë individuale dhe si anëtarë të grupeve bashkëpunuese;
 10. *zhvillon* me fëmijët tipe të ndryshme lojërash, duke shfrytëzuar të gjitha mjediset e kopshtit, të brendshme dhe të jashtme, lojërat individuale, në dyshe, në grupe të vogla ose me të gjithë fëmijët;
 11. në çdo mjedis fëmijët *kanë* mundësi të zhvillojnë një ose disa prej aftësive: zgjidhjen e problemeve, vëzhgimin, zbulimin, kërkimin, bashkëpunimin, komunikimin dhe marrëdhëniet sociale;
 12. *është* i vëmendshëm në luftimin e stereotipeve, të diskriminimeve pozitive dhe negative që rrjedhin nga faktorë të ndryshëm;
 13. e *organizon* mjedisin e klasës në bazë të këndeve/qendrave të veprimtarisë, si: këndi/qendra e lexim-shkrimit, këndi/qendra e matematikës/shkencës (këndi/qendra e rërës, ujit), këndi/qendra e kukullës, këndi/qendra e pushimit, këndi/qendra e kuzhinës etj., dhe i

- pasuron në vazhdimësi me mjete dhe materiale të ndryshme, sipas tematikave mësimore, projekteve që realizohen gjatë vitit shkollor;
14. *krijon* qendra aktiviteti të pajisura me materialet dhe lodrat e duhura. Siguron mjete mësimore, përfshirë TV, DVD, video, kompjuter, lodra lëvizore dhe objekte të nevojshme për kryerjen e eksperimenteve;
 15. *përzgjedh* strategji efektive për të siguruar pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në aktivitetet e organizuara në mjediset e brendshme dhe të jashtme të kopshtit;
 16. *eksponon* në vende të dukshme punët individuale të fëmijëve ose punimet e përgatitura në grup;
 17. *përdor* ngjyra për të tërhequr atë që duhet vëmendjen e fëmijëve;
 18. *kujdeset* për ndriçimin e mjaftueshëm të klasës dhe për ajrosjen e mjedisit;
 19. *përdor* teknikat e menaxhimit të klasës dhe të disiplinimit pozitiv që nxisin vetëkontrollin dhe vetëdisiplinën;
 20. *shfaq* përkushtimin e tij të vazhdueshëm në përmirësimin e kushteve të klasës.

2.3.10 Standardi 10. Vlerësimi në arsimin parashkollor

2.3.10.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i arsimit parashkollor realizon vëzhgime sistematike të fëmijëve të grupit. Ky proces realizohet duke dëgjuar dhe vëzhguar fëmijët gjatë kryerjes së punimeve, lojërave dhe veprimtarive të ndryshme, kur i realizon individualisht, në çift ose në grup. Mësuesi përpiket t'i njohë sa më mirë fëmijë, duke njohur pikat e forta, dobësitë, vështirësitë dhe nevojat, të cilat i mban parasysh në planifikimin e veprimtarive të ndryshme mësimore.

Mësuesi përdor teknika të shumëfishta vlerësimi dhe i përdor ato në mënyrë efektive. Përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vëzhgon, monitoron dhe dokumenton sjelljet dhe veprimtaritë e fëmijëve; i analizon, të dhënat, ua komunikon prindërve dhe përmirëson veprimtarinë mësimore-edukative.

2.3.10.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. është njohës i mirë i kornizës kurrikulare të arsimit parashkollor;
2. mban parasysh parimet themelore mbi të cilat mbështetet vlerësimi;
3. e përqendron vlerësimin në zbatimin e standardeve dhe pritshmërive të progresit dhe arritjes së fëmijëve në njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e përcaktuara në kurrikulën shkollore;
4. i vëzhgon në mënyrë sistematike dhe të qëllimtë fëmijët gjatë kohës që luajnë dhe kryejnë

- aktivitete të ndryshme;
5. *i motivon* fëmijët për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë;
 6. *bën* të mundur që çdo fëmijë ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i dashur nga të tjerët;
 7. *krijon* dhe përshtat teknika vlerësimi që i përgjigjen zhvillimit individual të fëmijës në përputhje me programin mësimor;
 8. *përdor* mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të arritjeve të çdo fëmije;
 9. *përdor* gjeste ose simbole vlerësuese, në përshtatje me grupmoshën e fëmijëve;
 10. *nuk përdor* fjalë fyese ose diskriminuese;
 11. *krijon* portofolin e zhvillimit dhe të të nxënit për çdo fëmijë, në të cilin dokumentohen detyra e punime të lidhura me tema, interesa, prirje dhe kërkesa të ndryshme pedagogjike;
 12. *nxit* vetëvlerësimin dhe vlerësimin pozitiv të fëmijëve për njëri-tjetrin;
 13. *përdor* të njëjtat kritere vlerësimi për të gjithë fëmijët;
 14. *mban* shënime për zhvillimin e fëmijëve, progresin në të nxënë, përfshirjen e fëmijëve në punë në grupe dhe si i përgjigjen ata punëve të përbashkëta;
 15. *komunikon* në mënyrë efektive me prindërit rreth përparimit të fëmijëve dhe planifikojnë së bashku detyrat për të ardhmen;
 16. *ka* dokumentacion të pasur për çdo fëmijë që dëshmon zhvillimin e tij intelektual, social, gjuhësor, fizik dhe emocional;

17. *vlërëson* çdo fëmijë për atë që di dhe është në gjendje të bëjë;
18. *dokumenton* dhe përdor metoda produktive për vetëvlërësimin e fëmijëve;
19. *vëzhgon*, pyet dhe dëgjon fëmijët për të kuptuar atë që thonë dhe mendojnë fëmijët;
20. *përdor* një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për fëmijët kur bën vlerësimin e tyre;
21. *i përditëson* vazhdimisht të dhënat rreth fëmijëve me shembuj të rinj;
22. *i nxit* vazhdimisht fëmijët të marrin përgjegjësi për të nxënë të tyre, për atë që kanë mësuar, për aftësitë dhe shprehitë e reja që kanë fituar;
23. *vlërëson* aftësitë e fëmijëve për të punuar me të tjerë, për të ndarë lodrat me të tjerët, me dëshirën e tij, për respektimin e rregullave të grupit;
24. *i jep* prindit informacion të rregullt për progresin e fëmijës.

Standardi 11. Vlerat dhe kompetencat e mësuesit në arsimin gjithëpërfshirës

2.3.10.3 Përshkrimi i standardit

Gjithëpërfshirja është një qasje parimore, e bazuar tek e drejta për arsim në themel të së cilës qëndrojnë një sërë vlerash të rëndësishme. Arsimi gjithëpërfshirës është përgjegjësi e çdo mësuesi, prandaj ai duhet të jetë i përgatitur të punojë në institucione dhe të krijojë mjedise gjithëpërfshirëse. Dallimet ndërmjet fëmijëve, mësuesi gjithëpërfshirës i konsideron si burime dhe vlera për edukimin, sepse fëmijët kanë ritme të ndryshme zhvillimi; çdo fëmijë është unik dhe është normale “të jesh i ndryshëm” nga të tjerët. Mësuesi ka ka pritshmëri të larta për arritjet në zhvillim dhe të nxënë të çdo fëmije.

2.3.10.4 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

1. zotëron njohuri për arsimin gjithëpërfshirës;
2. vlerëson gjithëpërfshirjen si një proces që sjell përfitime edhe për fëmijët e tjerë, duke bërë që secili në klasë të jetë pranues, jodiskriminues dhe mbështetës ndaj bashkëmoshatarëve të tjerë;
3. mundëson që të gjithë fëmijët të jenë pjesëmarrës dhe të përfshihen në veprimtari të të nxënimit që janë të përshtatshme për mundësitë që kanë;
4. tregon empati ndaj nevojave të ndryshme të fëmijëve;
5. kontribuon në ndërtimin e kopshteve si komunitete të dijes e të zhvillimit që respektojnë, nxisin dhe vlerësojnë aftësitë e të

- gjithë fëmijëve;
6. *planifikon* mësimdhënien në bazë të nevojave, interesave dhe stileve të të nxënit;
 7. *përshtat* metodat e mësimdhënies sipas diversitetit të fëmijëve;
 8. *mbështet* fëmijët për të qenë të pavarur dhe autonomë, bashkëpunues dhe aktiv gjatë veprimtarisë mësimore-eduaktive;
 9. *përfshin* në mënyrë aktive prindërit për të mbështetur procesin e të nxënit të fëmijëve të tyre;
 10. *komunikon* dhe *bashkëpunon* me familjarët me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore për krijimin e kulturës dhe praktikave gjithëpërfshirëse.

